



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

A. nr. 412 / 20

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “Printing Press SH.P.K Prishtinë”, të parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për dhënie të kontratës OE “Vjllca Birinxhiku” Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shtypja e Kompletit të veprave të Anton Çetës” me numër të prokurimit 208-20004221”, të iniciuar nga AK Ministria e Arsimit, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 26 QERSHOR 2020 mori këtë :

VENDIM

- I. Hedhet poshtë si e jashtë afatshme** ankesa e OE “Printing Press SH.P.K Prishtinë, me nr. të protokolli. 412/20, e datës: 24 QERSHOR 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shtypja e Kompletit të veprave të Anton Çetës” me numër të prokurimit 208-20004221”, të iniciuar nga AK Ministria e Arsimit, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

- II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Ministria e Arsimit , që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shtypja e Kompletit te veprave të Anton Çetës “ me numër te prokurimit 208-20004221”, te iniciuar nga AK Ministria e Arsimit,, përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).
- III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar sipas nenit 108/A dhe 109 te LPP-së si dhe nenin 9 te Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave , operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës konform nenit 31 pika 4 te Rregullores të Punës së OSHP-së.
- IV. **Obligohen**, OE ankues që konform nenit 31 pika 6 te Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 24 QERSHOR 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “Printing Press” SH.P.K Prishtinë, me nr. te protokollit 412/20 kundër njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shtypja e Kompletit te veprave të Anton Çetës “ me numër te prokurimit 208-20004221”, te iniciuar nga AK Ministria e Arsimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE “Printing Press SH.P.K Prishtinë, me nr. të protokollit. 412/20, e datës: 24 QERSHOR 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shtypja e Kompletit te veprave të Anton Çetës “ me numër te prokurimit 208-20004221”, te iniciuar nga AK Ministria e Arsimit dhe konstaton se e njëjta ankese është parashtruar në OSHP, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e publikimit të vendimit te AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim te vendimit te AK-së, te parashtruar nga

OE "Printing Press SH.P.K Prishtinë.

Autoriteti kontraktues (AK) Ministria e Arsimit për aktivitetin e prokurimit "Shtypja e Kompletit te veprave të Anton Çetës " me numër te prokurimit 208-20004221", me Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar e ka njoftuar OE ankues me dt. 04.06.2020, në ora 10:52. Operatori ekonomik (OE) ankues kërkesën për Rishqyrtim te vendimit të AK-së e ka parashtruar me dt. 05.06.2020 ora 10:34.

AK me dt. 09.06.2020 në ora 14:17 ka marr vendim për refuzim te kërkesës për Rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK nuk i ka kthyer fare përgjigje ne kërkesën e tij për Rishqyrtim , Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), ka kërkuar nga KRPP te japin sqarime se AK Mistria e Arsimit a i ka kthyer përgjigje OE "Printing Press SH.P.K Prishtinë, lidhur me kërkesën e tyre për rishqyrtim përmes sistemit te e-prokurimit dhe ne cilën date kanë kthyer përgjigje për operatorin ekonomik ankues , autoriteti kontraktues.

KRPP me dt.24.06.2020, konfirmon për OSHP-në, se AK Ministria e Arsimit i ka kthyer përgjigje OE "Printing Press SH.P.K Prishtinë, në kërkesën për Rishqyrtim dhe atë me dt. 09.06.2020 në ora 14:17 minuta.

Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit, duke pas parasysh faktin se AK me dt. 09.06.2020, ka marr vendim për refuzim te kërkesës se OE "Printing Press SH.P.K Prishtinë, afati ligjor sipas LPP-së , për ankese në OSHP për OE ankues ka filluar te rrjedh nga data 10.06.2020(duke pas përsysh faktin se dita e njoftimit llogaritet dita 0).

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstatonë se OE "Printing Press SH.P.K Prishtinë, ka humbur afatin kohor për parashtrim te ankesës në OSHP për faktin se afati i fundit sipas LPP-se, për ushtrim te ankesës për aktivitetin e prokurimit në fjale nga OE në fjale ka qenë data 20.06.2020, ora 16:00.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 9 paragrafi 1 te Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së,

dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si me lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE “ Printing Press SH.P.K Prishtinë, me nr. të protokolli. 412/20, e protokolluar me datë: 24 QERSHOR 2020, është parashtruar në OSHP jashtë afatit ligjor të parapara me nenin 108/A dhe 109 të LPP- së, si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa afatshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Ministria e Arsimit

1x1 OE “Printing Press SH.P.K Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

Ardian BEHRA